



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr. 728/prot.

Tiranë, më 15.01.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1285 datë 18.12.2008

SHOQËRISË "QATO - 01" SHPK
Polican, Skrapar, Qarku Berat

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "Qato - 01" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1285 datë 18.12.2008, për mineral gëlqeror pllakore, në objektin "Zhitom i Madh", në Qarkun Berat.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.9727 datë 09.11.2016, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.6747 datë 10.11.2016, shkresën nr.5799 datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5378 datë 01.08.2017, dhe shkresën nr.5380/1 datë 10.10.2017, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 729 datë 11.10.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1285 datë 18.12.2008, për mineral gëlqeror pllakore, në objektin "Zhitom i Madh", në Qarkun Berat, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për vitin 2016 -2017 dhe mosmiratimin e programit të punës për vitin 2016 - 2017.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 datë 17.02.1994 "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me ligjin nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën "ç" të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1285 datë 18.12.2008, për mineral gëlqeror pllakore, në objektin "Zhitom i Madh", në Qarkun Berat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1285 datë 18.12.2008, për mineral gëlqeror pllakore, në objektin "Zhitom i Madh", në Qarkun Berat.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN G.JIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

